

PROFILI SHOQËROR

Udhëzime për vlerësimin

Kjo është një skemë qortimi, në të cilën jepen disa orientime lidhur me vlerësimin e përgjigjeve të nxënësit.

- Testi përmban një total prej **50 pikësh**.
- Testi përbëhet nga dy pjesë: një në poezi dhe një në prozë.
- Secila pjesë ka nga 10 pyetje dhe përkatësisht 25 pikë.
- Pyetjet janë të dy tipeve: me zgjedhje dhe me zhvillim.
- **Pyetjet me zgjedhje vlerësohen me 1 pikë.**
- Pyetjet me zhvillim vlerësohen nga 3 deri në 6 pikë.
- Në secilën pjesë pyetja e fundit është e tipit ese (me fund të hapur).
- Pyetjet me zhvillim do të vlerësohen në bazë të një skeme orientuese të detajuar.

Në vlerësimin e pyetjeve ese duhet patur parasysh:

- Përgjigjja e nxënësit duhet vlerësuar në tërësinë e saj, për cilësinë që paraqet, për ndjeshmërinë, mendimin, idetë që ka shprehur dhe nëse ajo që ka shkruar është interesante dhe origjinale apo jo.
- Nxënësit që kanë probleme në drejtshkrim, por arrijnë të komunikojnë me shkrim një të kuptuar të qartë të pjesës letrare (të tekstit të dhënë) dhe të pyetjes, do të marrin pikët e plota për të kuptuarit. Nga ana tjetër, nxënësit që shkruajnë qartë, rrjedhshëm dhe pa gabime, por nuk dëshmojnë ndonjë të kuptuar të mirë të tekstit dhe pyetjes, do të marrin pikë për mënyrën e shprehjes, stilin dhe saktësinë drejtshkrimore, por nuk do të vlerësohen për të kuptuarin. **Mos harroni** se ky është një provim që vlerëson **aftësitë letrare** (përgjigjen letrare) dhe **jo aftësitë gjuhësore**.
- Gabime që nuk ndikojnë në cilësinë e përgjithshme të përgjigjes nuk do të merren në konsideratë në vlerësim. Do të hiqen pikë vetëm për ato gabime që ndikojnë mbi cilësinë dhe që i gjykoni si të rënda.

PJESA I

NDRE MJEDA

Skema e përgjigjeve

Kërkesa 1 **A**

Kërkesa 2 **C**

Kërkesa 3 **B**

Kërkesa 4 **D**

Kërkesa 5 **B**

Kërkesa 6 **2 pikë**

1 pikë Nëse gjen vargjet ku shprehet optimizmi për jetën.

P.sh.

*Kur u zgjue Zoga vojt te balkoni,
E pau se bleta vëlote te zgjoni;
Pau se n'at nade poshtë një lavnuer
Kish ba një shpuer.*

1 pikë Nëse gjen vargjet ku jepet shpresa për jetën.

P.sh.

*Rreze, flakë arit. Po rrotull fëtyra
E fushës kish nd'rrue, kish ndrruemun zyra
E bimës e e pemve, përmi balkue
Deri kish ndrrue
Ose
Nuk erdhi djali: veç dy bylbyla,
Një n'drandofille, një ndër zymbyla,
Përmallshëm thrrasin e shoqi-shojnë
Me kangë gazmojnë.*

Nxënësi mund të gjejë edhe vargje ose strofa të tjera

Kërkesa 7 **4 pikë**

Model përgjigjeje

Disa nga figurat stilistike:

Skemat e qortimit të testeve, letërsi sesioni I

Paralelizmi figurativ: është figura bazë mbi të cilën ndërtohet i gjithë ky fragment. Ripërtëritja e natyrës paralelizohet me gjallërinë shpirtërore të vajzës.

Krahasimi: si valë dedi, si zhgjeta, porsì makthit, posi 'j selvi etj. Shpjegim për atë krahasim që do të zgjedhë.

Aliteracioni: E ushtote toka (t, o), krijon idenë e shpërthimit pranveror, ekstazës pranverore.

Enumeracione dhe epitete: i ri, i hollë, e i gjatë.

Etj.

- 2 pikë** nëse gjen dy figura stilistikore.
- 2 pikë** nëse bën shpjegimin e secilës.
- 1 pikë** nëse gjen vetëm një figurë stilistikore.
- 1 pikë** nëse jep vetëm një shpjegim.
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur gjen figura që nuk i përmban lista e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit i gjykon si të sakta.

Kërkesa 8 4 pikë

Model përgjigjeje

- Detajet me të cilat jepet ardhja e stinës së pranverës janë foljet, si *ushtote, rrahun, vëlote, lëshote, rridhte, dalun*, këndote etj që japin imazhin e përtëritjes pranverore, e ndryshimit që sjell stina.
Emra: bagëtia, Mica dhe Harapi, bleta
Ose strofa që përmban tërë thelbin e kësaj përtëritjeje.
*Tuj sjellun krahnin këndote me vedi,
E i rridhte krahve një si valë dedi,
Ku shndriçëm dielli lëshote si zhgjeta
Rrezet e veta.*
- Detajet i japin poezisë ngjyrim romantik, duke patur parasysh se dashuria për romantikët lind në pranverë.
Qëndrimi i nxënësit është i lirë, por duhet argumentuar.
- Zoga i vë re këto ndryshime tani sepse është në moshën e ndryshimeve, është në adoleshencë dhe ndjeshmëria ndaj natyrës është e madhe.

Matura Shtetërore 2006, Teste

- Dashuria nuk ka lindur ende, por ajo është duke u përgatitur për të. Gjithë ky shndërrim në natyrë ka sjellë shndërrim dhe te vetë Zoga.
- Strofa e katërt përmban pikërisht ndjeshmërinë e lartë të Zogës.

- 1 pikë** nëse gjen disa nga detajet e dhëna më sipër.
- 1 pikë** nëse shpjegon se ç'loj ngjyrimi është: romantik apo realist.
- 1 pikë** nëse shpjegon se pse Zoga i vë re ndryshimet pikërisht në këtë moment.
- 1 pikë** nëse shpjegon nëse Zoga është e dashuruar apo ende jo.
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep shpjegime dhe arsytetime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon si të sakta.

Kërkesa 9 4 pikë

Model përgjigjeje

- Mjeshtëri i fjalës poetike. Përdorimi i figuracionit të zgjedhur, përzgjedhja e fjalës poetike, rregullsia formale.
 - Rregullsia metrike. Fragmenti është i përbërë nga 12 strofa. Strafat janë të përbëra nga 3 vargje 10 – rrokëshe (5 rrokëshe të dyzuara) dhe vargu i fundit i strofës është 5 – rrokësh.
 - Të gjitha strofat i përmbahen kësaj skeme duke krijuar rregullsi dhe harmoni metrike.
 - Rima në strofën e parë është: AA AA; strofa e dytë është BB AA etj.
- 1 pikë** nëse shpjegon pse mendon se Mjeda është mjeshtër i fjalës poetike.
- 1 pikë** nëse gjen elemente të vargëzimit.
- 1 pikë** nëse jep arsyen e harmonisë metrike
- 1 pikë** nëse shpjegon llojin e rimës.
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.
- Do të pranohen si të sakta edhe përgjigje të tjera, që gjykohen si të tilla nga komisioni i vlerësimit.

Kërkesa 10 6 pikë

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

Skemat e qortimit të testeve, letërsi sesioni I

KRITERI I: IDEJA DHE ARGUMENTIMI

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- e ka kuptuar qartë në pikëpamje përmbajtësore dhe artistike tekstin e dhënë (fragmentin).
- përcakton teknikat e përdorura nga autori për të arritur efekte të caktuara artistike.
- interpreton në mënyrë analitike pjesën.
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga teksti i dhënë.

KRITERI II: ORGANIZIMI I PËRGJIGJEVE

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen.
- përdor detaje mbështetëse.
- ka qartësi mendimi.

KRITERI III: SAKTËSIA DREJTSHKRIMORE

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- ka saktësi drejtshkrimore.
- përdor si duhet shkronjën e madhe.
- përdor si duhet shenjat e pikësimit.

PJESA II

HEMINGUEJ – LAMTUMIRË ARMË

Kërkesa 11	A
Kërkesa 12	C
Kërkesa 13	B
Kërkesa 14	D
Kërkesa 15	A
Kërkesa 16	3 pikë

Model përgjigjeje

- Lidhja është shumë e thellë. Kanë nevojë për të qëndruar bashkë në një moment të tillë: Ketrin për të sfiduar vdekjen dhe Henri për ta patur Ketrinën deri në momentet e fundit.
- Ketrin nuk e pranon priftin, Henri po.
- Ai nuk e braktis deri në fund. Nuk e koncepton dot jetën pa të.
- Ilustrime: *U kërrusa mbi shtratin e saj duke qarë. I kappa dorën/ Vetëm ty të dua/ Ato që i kemi bërë bashkë, nuk do t'i bësh me grua tjetër, mirë? Nuk do t'i thuash askujt ato që më thoshe mua?*
- Jo, kurrë.

Etj.

2 pikë nëse nxënësi tregon se e ka kuptuar qartë dhe saktë thelbin e kësaj lidhjeje.

1 pikë nëse nxënësi tregon se e ka kuptuar mjaftueshëm lidhjen midis dy heronjve.

1 pikë Ilustrimet.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim (nuk ka kuptuar thelbin e lidhjes) ose nuk përgjigjet fare.

Kërkesa 17 4 pikë

Model përgjigjeje

- Karakteristikë e stilit të autorit. Dialogu duket i thjeshtë por ka ngarkesë ideoemocionale të madhe, gjuhë e thjeshtë, e zgjedhur me kujdes. Ai flet mes rreshtave. Mes tyre kuptojmë ankthin, tensionin, frikën, forcën, hidhërimin që ekziston midis dy personazheve.

Skemat e qortimit të testeve, letërsi sesioni I

- Parimi i ajsbergut gjen zbatim përmes nëntekstit (1/3 është e shkruar dhe pjesa tjetër(2/3) është e nënkuptuar). Pjesa më e madhe nënkuptohet, ka shumë pika heshtjeje. Lexuesi është i lirë ta interpretojë dhe përfytyrojë këtë dialog në mënyrën e vet.
- 2 pikë** nëse shpjegon qartë dhe saktë arsyen e përdorimit të një teknike të tillë.
- 1 pikë** nëse shpjegon pjesërisht arsyen e përdorimit të kësaj teknike.
- 2 pikë** nëse shpjegon qartë dhe në mënyrë të plotë se si zbatohet parimi i ajsbergut.
- 1 pikë** nëse shpjegon në mënyrë të pjesshme zbatimin e parimit të ajsbergut.
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.
Interpretimi është i lirë, por nxënësi duhet të tregojë se di të shpjegojë qartë thelbin e stilit të Heminguejit.

Kërkesa 18 3 pikë

Model përgjigjeje

- Burimi i fatalitetit është dhimbja njerëzore e shkaktuar nga humbja e dashurisë dhe që kthehet në tragjedi. Nuk mund të jenë të lumtur kur e gjithë jeta e tyre është e rrethuar nga lufta, nga kasaphana dhe tragjeditë që ajo shkakton. Çmenduria njerëzore është e pandalshme, tragjedia fatale bëhet pjesë e tyre.
 - Interpretimi është i lirë por duhet të jetë i argumentuar.
- 3 pikë** nëse shpjegon qartë burimin e fatalitetit, duke treguar se e ka kuptuar saktë thelbin e personazheve të Heminguejt.
- 2 pikë** nëse shpjegon mjaftueshëm burimin e fatalitetit.
- 1 pikë** nëse shpjegon pjesërisht burimin e fatalitetit, duke treguar se e ka kuptuar si duhet thelbin e personazheve të Heminguejt.
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.
Shpjegimi është i lirë, por nxënësi duhet të tregojë se e ka kuptuar qartë dhe fokusohet si duhet në atë që përbën thelbin e këtyre personazheve.

Kërkesa 19 4pikë

Model përgjigjeje

- Ndjenjat që i shoqërojnë janë: trishtimi, zhgënjimi, pikëllimi i thellë që paralajmërojnë vdekjen e afërt. Në fund të fragmentit Henri është i

Matura Shtetërore 2006, Teste

mpirë dhe duket si indifferent, por në thellësi të tij ndjehet pikëllimi dhe dhimbja e pamatë.

- Jo dramë sentimentale. Skena është realiste. Personazhet ndërgjegjësohen për vdekjen dhe e sfidojnë atë duke e urreyer dhe duke e jetuar dashurinë deri në fund.

2 pikë nëse shpjegon qartë ndjenjat që i shoqërojnë dy heronjtë.

1 pikë nëse shpjegon mjaftueshëm ndjenjat e dy heronjve.

2 pikë Nëse shpjegon arsyet se pse kjo është një dramë realiste ose jo.

1 pikë nëse shpjegon pjesërisht se pse kjo është një dramë realiste ose jo. Interpretim i lirë. Interpretimi mund të jetë edhe krejtësisht i ndryshëm, por në çdo rast ai duhet të jetë i argumentuar dhe mjaft i qartë.

Kërkesa 20 6 pikë

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: IDEJA DHE ARGUMENTIMI

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- e ka kuptuar qartë në pikëpamje përmbajtësore dhe artistike tekstin e dhënë (fragmentin).
- përcakton teknikat e përdorura nga autori për të arritur efekte të caktuara artistike.
- interpreton në mënyrë analitike pjesën.
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga teksti i dhënë.

KRITERI II: ORGANIZIMI I PËRGJIGJEVE

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen.
- përdor detaje mbështetëse.
- ka qartësi mendimi.

KRITERI III: SAKTËSIA DREJTSHKRIMORE

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- ka saktësi drejtshkrimore.
- përdor si duhet shkronjën e madhe.
- përdor si duhet shenjat e pikësimit.